


Indeksi i Çmimeve të Importit

Tremujori II, 2023

Tiranë, më 06 Shtator: Indeksi i Çmimeve të Importit, në tremujorin e dytë të vitit 2023, arriti 112,3 kundrejt vitit 2020 si periudha bazë. Krahasuar me tremujorin e dytë 2022, indeksi i çmimeve të importit shënoi një rritje me 0,2 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 10,7 %. Ndryshimi tremujor i indeksit të çmimeve të importit në tremujorin e dytë 2023, krahasuar me tremujorin e parë 2023 shënoi një ulje me 0,7 %.

Fig.1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit sipas tremujorëve



Ndryshimi vjetor: Çmimet e importit të produkteve në seksionin “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” kanë shënuar rritje me 4,7 %, pasuar nga seksioni “Industri nxjerrëse” me 0,4 %. Çmimet në seksionin “Industria përpunuese” me peshën më të madhe prej 90,6 % shënuan një rritje prej 0,2 %. Brenda këtij seksioni rritja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë” me 5,3 %, pasuar nga “Konfeksionimi i veshjeve” me 3,1 %, “Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara” me 2,9 %, “Prodhimi i pijeve” me 1,9 %, “Përpunimi i tekstileve” me 1,8 %, “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 1,5 %, “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” dhe “Prodhimi i paisjeve elektrike” me 1,0 % secili, etj. Çmimet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avulli dhe ajri kondicionuar” shënuan një ulje prej 0,2 %, krahasuar me një vit më parë.

Ndryshimi Tremujor: Krahasuar me tremujorin e parë 2023, çmimet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avulli dhe ajri kondicionuar” shënuan një ulje prej 4,1 %, pasuar nga seksionet “Industri nxjerrëse” me 0,8 %,

Për publikim 06/09/2023

“Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 0,7 % dhe “Industria përpunuese” me 0,4 %. Brenda seksionit “Industria përpunuese” ulja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Prodhimi i produkteve të duhanit” me 2,9 %, pasuar nga “Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë” me 2,1 %, “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure” me 1,4 %, etj.

Tab.1 Indeksi i Çmimeve të Importit

2020=100

NVE Rev.2	Përshkrimi	Peshat	4-23	5-23	6-23	II-23
	Gjithsej	100,0	112,7	112,2	112,1	112,3
B	Industri Nxjerrëse	0,2	115,4	115,3	115,3	115,4
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	115,4	115,3	115,3	115,4
C	Industria Përpunuese	90,6	110,0	110,0	109,9	109,9
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	13,0	118,6	118,6	118,6	118,6
11	Prodhimi i pijeve	3,6	117,4	117,4	117,4	117,4
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	106,7	106,7	106,7	106,7
13	Përpunimi i tekstileve	3,4	108,9	108,9	108,9	108,9
14	Konfeksionimi i veshjeve	3,5	109,9	109,9	109,9	109,9
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	2,6	104,3	104,3	104,3	104,3
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	3,4	108,0	108,0	107,6	107,9
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	1,9	107,1	107,3	107,3	107,2
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	117,6	117,6	117,6	117,6
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	8,6	112,8	112,8	112,4	112,7
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	5,9	108,6	108,6	108,6	108,6
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	8,8	104,3	104,3	104,3	104,3
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	3,0	103,5	103,3	103,3	103,4
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,9	114,6	114,6	114,6	114,6
24	Metalurgjia	8,7	115,7	115,7	115,7	115,7
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	2,8	106,4	106,4	106,4	106,4
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	3,5	107,2	107,2	106,9	107,1
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	5,0	111,5	111,8	111,0	111,4
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p,k,t	4,7	105,1	105,1	105,1	105,1
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,3	111,4	111,4	111,4	111,4
31	Prodhimi i mobiljeve	0,9	103,5	103,5	103,5	103,5
32	Industri të tjera p,k,t	1,8	104,4	104,4	104,4	104,4
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	8,0	184,7	175,0	175,0	178,2
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	8,0	184,7	175,0	175,0	178,2
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,2	112,7	112,7	112,7	112,7
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,2	112,7	112,7	112,7	112,7

Tab.2 Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit

në %

NVE	Përshkrimi	Peshat	II- 23 / I- 23	II- 23 / II- 22
	Gjithsej	100,0	-0,7	0,2
B	Industri Nxjerrëse	0,2	-0,8	0,4
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	-0,8	0,4
C	Industria Përpunuese	90,6	-0,4	0,2
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	13,0	-0,1	1,5
11	Prodhimi i pijeve	3,6	0,9	1,9
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	-2,9	-0,5
13	Përpunimi i tekstileve	3,4	-0,4	1,8
14	Konfeksionimi i veshjeve	3,5	0,6	3,1
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	2,6	-1,4	-0,2
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	3,4	-1,1	0,6
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	1,9	0,1	0,8
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	0,9	2,9
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	8,6	-0,7	-7,0
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	5,9	-0,3	-0,4
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	8,8	0,1	5,3
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	3,0	-0,5	-1,2
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,9	0,7	1,0
24	Metalurgjia	8,7	-1,3	-4,7
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	2,8	0,4	0,2
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	3,5	-2,1	-1,9
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	5,0	0,8	1,0
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	4,7	-1,1	-0,1
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,3	0,4	-3,3
31	Prodhimi i mobilie	0,9	-0,2	-2,8
32	Industri të tjera p,k,t	1,8	-0,1	-0,5
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	8,0	-4,1	-0,2
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	8,0	-4,1	-0,2
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,2	-0,7	4,7
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,2	-0,7	4,7

Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Importit mat ecurinë e çmimeve të transaksioneve të produkteve industriale të importuara për tu shitur në tregun vendas,

INSTAT llogarit dhe publikon:

Indeksin e Çmimeve të Importit

Ndryshimet tremujore dhe vjetore të indeksit

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industri Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE rev.2) në nivel 2-shifror,

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar, Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori,

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe tremujorit të mëparshëm,